



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
Komuna Drenasit  
Municipality Drenas  
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060101-93352 dt. 18/06/2026

Në bazë të nenit 40,43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

**Th ë r r e t**

mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më datë: 29.06.2026 e cila do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur me datë: 29.05.2026
2. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029.
3. Raporti i KRU "Prishtina", Dega në Drenas
4. Raporti nga Kryeshefi i KRM "Pastrimi .
5. Raport për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim.
6. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën Janar-Qershor 2026.
7. Propozim vendim për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr.020/04-19807 të datës 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026.
8. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futbollit FC Feronikeli 74"
9. Propozim vendim për financimin e projektit OJQ "Klubi KFF FERONIKELI" Femra.
10. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futsalit FC "LIQENI"
11. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Shotë Galica"
12. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i volejbollit Gryka"
13. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ KV "FERONIKELI FEMRAT"
14. Propozim vendim për financimin e projektit OJQ KV "FERONIKELI MESHIKUJT"
15. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futsallit Drenasi"
16. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futsallit Komorani"
17. Të ndryshme

Drenas, 18.06.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/24-23292 dt. 18/06/2026

## PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 29.05.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë.

**Në mbledhje morën pjesë:** Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, anëtarët e Kuvendit: Ekrem Elshani (PDKRLL), Naim Gjeli (PDKRLL), Anjeza Kurtaj (PDKRLL), Selman Qallapeku (PDKRLL), Valdet Curri (PDKRLL), Qëndresë Xhema (PDKRLL), Gani Krasniqi (PDKRLL), Erblinë Morina (PDKRLL), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Edon Nishori (PDKRLL), Driton Ajazi (PDK), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Mërgim Pirraku (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Artian Krasniqi (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Xhavit Drenori (GREEN), Arbër Halilaj (BD), Mehedin Salihu (Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (LDK), Liman Krasniqi (NISMA).

**Munguan:** Tringa Bujupi (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, stafi i Zyrës së Kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale.  
Mbledhja do të ketë këtë

## REND DITE:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt.30.04.2026;
2. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi **Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës, mirëpo, pati kërkesa që të shtohen edhe disa pika të tjera, me ç'rast kryesuesi fjalën ia dha Kryetarit të Komunës.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sipas rekomandimeve të MAPL-së (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) dhe sipas sekretarisë tonë, sepse askush nuk më është drejtuar mua, ne kemi të drejtë të propozojmë pika të rendit të ditës pa kufi. Mirëpo rekomandimi i tyre është që një asambleist duhet të propozojë një pikë, pastaj ajo të votohet, dhe kur të votohen të gjitha propozimet, pastaj si tërësi të votohet rendi i ditës. Ne do të veprojmë sipas rekomandimeve të MAPL-së, sepse ata janë niveli i fundit që na jep vlerësimin e ligjshmërisë së akteve dhe dokumenteve. Pesë dokumente që do të propozohen sot nga asambleistët janë të domosdoshme, sepse janë kthyer nga MAPL-ja, tri dokumente për tri prona, të cilat, sipas tyre nuk kanë qenë të kompletuara.

Pra, ne do t'i propozojmë ato për ndryshim dhe shfuqizim. Nëse nuk veprojmë kështu, atëherë në grantin e performancës i humbim pikët, sepse jemi të detyruar t'i shfuqizojmë dokumentet të cilat na i ka kthyer MAPL-ja për plotësim të dokumenteve. Sa i përket vendimit të komisionit rekomandues, e kam cekur edhe më herët që ai vendim nuk ka pasur nevojë t'i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë. Unë mendoj që është gabim i sekretarisë që e ka dërguar atë vendim për vlerësim të ligjshmërisë, sepse asnjë ligj në Kosovë nuk thotë që nuk kam të drejtë të formoj komision për rekomandime, për arsye se komisionet rekomanduese nuk janë vendimmarrëse, por vetëm rekomandojnë. I nderuar kryesues, unë propozoj si pikë të dytë të rendit të ditës.

**Pika (2):** Propozim-vendim për përfshirjen e projektit të ri kapital në tabelën 4.2 'Ndërtimi i Urës në Shtrubullojë'. Nëse ju doni ta përfshini si pikë të rendit të ditës edhe ne do ta bëjmë buxhetin tonë për ta kryer urën. Nëse nuk doni dhe besoni që Ministri ka për ta kryer urën, le ta dinë qytetarët së nuk jemi ne ata që nuk po i bëjmë veprimet për ta ndërtuar urën dhe për t'ua lehtësuar jetën e tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e propozuar nga Kryetari. Nga 26 të pranishëm, 25 ishin për, 1 kundër, 0 abstenime. Kjo pikë kalon dhe përfshihet si pikë e rendit të ditës. Fjalën e merr asambleistja Fitore Morina-Hoxha (për prezantimin dhe arsyetimin e pikës së propozuar).

**Fitore Morina-Hoxha**, propozon pikën e tretë të rendit të ditës. **Pika (3):** Propozim-vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 nr. 462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies përmes negocimit apo shpalljes publike.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** sqaron se, votimi i këtij propozimi për përfshirje në rend të ditës është një detyrim ligjor, me qëllim që i njëjti vendim të shfuqizohet. Të njëjtin vendim prapë do ta votojmë dhe komisioni do të funksionojë mbi bazën e vendimit që do të marr unë si Kryetar Komune për komisionin për rekomandime.

**Egzona Tërdevci** ngriti shqetësimin se, rregulli i ri i prezantuar dëshmon se, Komuna u ka ikur procedurave ligjore për 5 vite rresht, pasi ligji nuk ka ndryshuar së fundmi.

Gjatë kësaj periudhe, udhëheqja e komunës i dërgonte pikat e rendit të ditës votëm përmes e-mailit dhe ato kalonin si të mirëqena pa u votuar ashtu siç e kërkonte ligji. Ajo thotë se ndihet mirë që më në fund Ministria (MAPL) i ka detyruar të reflektojnë. Më përpara, kur asambleistët propozonin pika të reja, udhëheqja nuk i hidhte fare në votim. Tani që po vendoset ky "standard i ri" ajo thotë se është e gatshme t'i qesë në votim dhe t'i kalojnë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, ndërhyr shkurt për të mbrojtur veten dhe ekzekutivin, duke thënë se ai asnjëherë nuk ka pasur qëllim të dalë mbi ligjin apo të kundërshtojë atë që thotë Ministria (MAPL).

**Xhavit Drenori**, kujton përvojën e tij si asambleist i mandateve të kaluara dhe thekson se kur anëtarët e Kuvendit ngrinin çështje për diskutim, kryesuesi dhe paraardhësit e tij nuk i hidhnin fare në votim, gjë që e cilëson si shkelje ligjore të vazhdueshme. Z. Drenori shpreh kënaqësinë që MAPL-ja ka ndërhyrë përmes zyrtarëve të sekretarisë, duke konfirmuar se secili anëtar i Kuvendit ka të drejtë të ngrisë çështje dhe të tentojë përfshirjen e tyre në rend dite. Ai tha se, nga sot e tutje kjo e drejtë të mos u mohohet më asambleistëve. Se nëse një anëtar propozon një pikë për rend dite, ajo duhet patjetër të hidhet në votim si procedurë që përcakton miratimin ose jo të saj, ndryshe nga praktikat e kaluara që kaloheshin me lehtësi.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** deklaroi se, sa herë që ka propozime që janë në interes të qytetarëve, ato gjithmonë do të vendosen si pika të rendit të ditës. Kryesuesi mbyll diskutimin për pikën e propozuar nga Fitore Morina dhe e hedhi në votim. Propozimi u miratua me 23 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenim. Pas votimit, fjalën e mori Erblina Morina.

**Erblina Morina**, propozon pikën e katërt për përfshirje në rend të ditës.

**Pika (4):** Propozim-vendim për shfuqizimin e Rregullorës për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore, Nr. 02-030-01-11323, të dt. 30.03.2026.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hedh në votim këtë propozim për t'u futur në rend të ditës dhe me 23 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenim, hynë në rend të ditës.

**Ekrem Elshani**, propozon pikën e pestë për përfshirje në rend të ditës.

**Pika (5):** Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vjet) të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së negociimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 130,000 m<sup>2</sup>, kapacitet 9.99 MW dhe vlerë investimi 5,800,000.00 €.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** deklaroi se, duhet të shfuqizohet vendimi përmes nenit 3, me ç'rast, pas miratimit të këtij vendimi, ai shfuqizohet.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e pestë për t'u futur në rend të ditës, e cila kaloi me 21 vota për, 0 kundër, 0 abstenime.

**Gani Krasniqi**, propozon pikën e gjashtë për përfshirje në rend të ditës.

**Pika (6):** Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vjet) të pronës së

paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 92,000 m<sup>2</sup>, kapacitet 5.70 MW dhe vlerë investimi 3,300,000.00 €.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, theksoi se edhe të ky propozim-vendim është neni 3 që e sqaron procedurën dhe me rastin e miratimit të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi paraparak.

**Xhavit Drenori**, kërkon sqarim nëse janë duke u shfuqizuar këto tri vendime, apo thjesht po futen si pika në rend të ditës për t'u shfuqizuar më pas gjatë seancës.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, ne jemi duke propozuar rendin e ditës dhe në rend të ditës brenda këtij vendimi është edhe vendimi për shfuqizim. Çdo vendim që ne e votojmë, nëse nuk shfuqizohet vendimi paraparak, nuk hyn në fuqi vendimi tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** e hodhi në votim pikën e gjashtë që të futet në rend të ditës, e cila kaloi me 21 vota për, 0 kundër, 0 abstenime.

**Valdet Curri**, propozon pikën e shtatë për përfshirje në rend të ditës.

**Pika (7):** Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vjet) të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së negocimit të ofertës për parcelën P-703150053-00539-0 në Negroc, me sipërfaqe 109,084 m<sup>2</sup>, kapacitet 5.90 MW dhe vlerë investimi 5,800,000.00 €.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e shtatë që të futet në rend të ditës, e cila kaloi me 23 vota për, 0 kundër, 0 abstenime.

**Arigon Sinani**, propozoi pikën e tetë të rendit të ditës.

**Pikën (8):** Propozim-vendim për formimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 deri në vitin 2026. Ai shtoi se, edhe pse kjo pikë ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, ajo nuk ka ardhur si rekomandim duke thënë se, nuk e dinte nëse është lënë me qëllim si pikë e fundit apo thjesht ashtu ishte radha.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** theksoi se, asgjë nuk bëhet me qëllim, por procedohet gjithmonë sipas radhës së grupeve parlamentare.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, deklaroi për dijeni e të gjithëve se, KPF-ja vetëm rekomandon dhe shqyrton dokumentet, ndërsa rendin e ditës e përcaktoi unë së bashku me kryesuesin. Ai shtoi se është pro që kjo kërkesë e z. Sinani të futet si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e tetë që të futet në rend të ditës, e cila kaloi me 25 vota për, 0 kundër, 0 abstenime.

**Egzona Tërdevci**, propozon pikën e nëntë për përfshirje në rend të ditës.

**Pika (9):** Mbështetje financiare e njehershme për fëmijët me Sindromën Down. Sqaron se ka tre muaj që e ka trajtuar këtë çështje si në Komitetin për Politikë dhe Financa, ashtu edhe në seancë. Tha se i është premtuar nga kryetari dhe nënkryetari se do të shikohen mundësitë

buxhetore, por deri më sot nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare, prandaj edhe po e paraqet këtë propozim.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, fton të gjithë asambleistët që të votojnë edhe për këtë pikë me qëllim që ajo të futet në rend të ditës, duke shtuar se shqyrtimi dhe debati rreth saj do të zhvillohen më vonë gjatë seancës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e nëntë që të futet në rend të ditës, e cila kaloi me 25 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, njoftoi për një pauzë prej pesë (5) minutash deri në renditjen zyrtare të pikave të reja, pas së cilës mbledhja do të vazhdon.

Pas pauzës pesëminutëshe, **Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hap sërish seancën dhe i hodhi në votim të gjitha pikat e propozuara për të miratuar rendin e ditës të plotësuar.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt.30.04.2026;
2. Propozim- vendim për shtim të projektit të ri kapital në tabelën 4.2 “Ndërtimi i Urës në Shtrubullojë”;
3. Propozim - vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 Nr.462/01-11329, për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies përmes negocimit apo shpalljen publike;
4. Propozim - vendim për shfuqizimin e Rregullorës për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore Nr. 02-030-01-11323, e dt. 30.03.2026;
5. Propozim - vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m<sup>2</sup>, kapaciteti 9.99 MW, vlera investive 5.800.000,00 €;
6. Propozim - vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 m<sup>2</sup>, kapaciteti 5.70 MW vlera investive 3.300.000,00 €;
7. Propozim - vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-703150053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m<sup>2</sup>, kapaciteti 5.90 MW vlera investive 5.800.000,00 €;
8. Propozim - vendim për formimin e
9. komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 deri në vitin 2026;
10. Mbështetje financiare e njëhershme për fëmijët me Sindrom Down;
11. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, konstatoi se në momentin e votimit të pranishëm ishin 25 anëtarë, 24 votuan për, 0 kundër dhe 1 abstenim. Rendi i ditës miratohet me ndryshimet e propozuara.

**Xhavit Drenori** tha se, rendi i ditës kaloi. Unë abstenova, por dua të bëj arsyetimin pse abstenova. Unë në mënyrë eksplicite ju pyeta. A jemi duke marrë vendim për t'i shfuqizuar, apo

shfuqizimin po e vendosim si pika të rendit të ditës. Ju z. Kryesues, thatë që ne po votojmë për t'i përfshirë si pika të rendit të ditës për shfuqizim. Askund këtu nuk ka shfuqizim, ne jemi duke marrë vendim mbi vendim, sepse këtu ka qenë e udhës të jenë edhe tri pika të tjera të rendit të ditës, së pari shfuqizimi i vendimit të kaluar, e pastaj të kthehet propozim-vendimi për dhënicën në shfrytëzim. Unë mendoj që kështu ka për t'u kthyer prapë nga MAPL-ja, sepse ne nuk mund të marrim vendim mbi vendim pa shfuqizim. Kjo nuk është mirë, të mbahet një mbledhje për të fuqizuar vendime e një për të shfuqizuar vendime. Kujdes, mos të bëjmë gabime kur kemi mundësi t'i shmangemi ato, sepse kjo nuk është e mirë as për qeverisjen tuaj.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës.

**Pika (1):** Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 30.04.2026. Pasi konstatoi se nuk ka diskutime nga anëtarët e Kuvendit, kryesuesi e hodhi në votim pikën e parë, 24 votuan për, 0 kundër, 1 abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.

**Pika (2):** Propozim-vendim për shtim të projektit të ri kapital në tabelën 4.2 "Ndërtimi i Urës në Shtrubullojë". Në mungesë të diskutimeve, pika u hodh në votim nga kryesuesi dhe kaloi me 23 vota për, 0 kundër, 2 abstenime.

**Egzona Tërdevci** potencoi se, zotimi i Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e urës në Shtrubullojë është bërë publik dhe se kërkesa e Komunës së Drenasit është pranuar. Ajo shtoi se, rëndësia e kësaj ure është e madhe pasi disa fshatra kanë mbetur të bllokuara dhe po shfrytëzojnë rrugë alternative. Tërdevci njoftoi kryetarin se, në ditët në vijim Ministria do të komunikojë me Komunën për procedurat e nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit. Për këtë arsye, ajo propozoi që kjo çështje të hiqet nga rendi i ditës në mënyrë që të mos dëmtohen projektet e tjera të planifikuara. Si sqarim teknik, ajo theksoi se, ashtu si Komuna edhe Ministria ka mungesë të kodit buxhetor për urat në rrugë lokale, pasi kodet ekzistuese mbulojnë vetëm rrugët nacionale dhe rajonale. Në fund, ajo u zotua publikisht në emër të Ministrit Basha (i cili ishte i zënë me aktivitete të tjera) dhe kërkoi me mirëkuptim largimin e kësaj pike nga rendi i ditës.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, bëri të ditur se Komuna i ka dërguar shkresë zyrtare Ministrisë që nga data 26.03.2026, përmes së cilës ka kërkuar që ky projekt të financohet nga niveli qendror. Kryetari njoftoi se më dt. 06.05.2026 ka pranuar një email kthyes nga shefi i kabinetit të Ministrit të Infrastrukturës, Bajrush Rrahmani, gjuhën dhe edukatën e të cilit e cilësoi si për të ardhur keq, pasi ai kishte deklaruar se ky projekt nuk ishte paraparë në buxhet dhe se ishte në kundërshtim me procedurat. Kryetari shtoi se, nuk mund ta parashikojnë se çfarë mund të ndodhë një vit më pas, ndonëse ka treguar gjithmonë kujdes të shtuar ndaj Ministrisë dhe Qeverisë, duke qenë se, lumi është pronë e kësaj të fundit.

Kryetari sqaroi se, autoritetet qendrore kanë pastruar një pjesë të hapësirës, por ka mbetur ende pa u përfunduar segmenti i dytë, ku është punuar nga Pokleku (lagja e Balccëve) deri në fshatin Shtrubullojë, përkatësisht deri te ura e gjimnazit. Do të ishte shumë më mirë që Qeveria ta merrte përsipër përfundimin e këtij projekti, pasi ajo i ka mundësitë për zhvillimin e procedurave më të shpejta. Në fund, duke iu drejtuar asamblistes Egzona Tërdevci, theksoi se nuk bazohet në komunikimet e Facebook-ut, pasi ato nuk përbëjnë komunikim zyrtar institucional, t'i sugjerojë

Ministrisë që të dërgojë një konfirmim zyrtar me e-mail se merr përsipër rregullimin e urës, pasi një projekt i tillë do t'u shërbente të gjithë qytetarëve të Drenasit.

**Egzona Tërdevci** reagoi duke thënë se, nuk është i drejtë konstatimi i kryetarit për ato që u tha ndaj shefit të kabinetit, si për mungesën e edukatës, ashtu edhe për pjesët e tjera. Ajo sqaroi se, askund në shkresë nuk është thënë se Komuna nuk i ka parashikuar vërshimet, por është thënë se, nuk janë parashikuar investimet. Po ashtu shtoi se, shefi i kabinetit thjesht ka treguar që nuk ka pasur rishikim të buxhetit për shkak të situatës me Kuvendin dhe që nuk ekziston një kod buxhetor, duke i vlerësuar të gjitha këto si informacione logjitime për t'ia përcjellë Komunës. Në vijim, ajo u zotua përsëri publikisht, duke theksuar se, nuk do ta merrte përsipër këtë zotim pa qenë 100% e sigurt. Ajo siguroi se, në kohën më të shpejtë të mundshme Ministria do ta kontaktojë Komunën lidhur me ndërtimin e kësaj ure. Në fund, ajo i kërkoi me mirëkuptim kryetarit që ta tërheqë këtë pikë nga rendi i ditës, me arsytimin se, nuk ka nevojë të dëmtohen projektet e vetë Komunës.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sqaroi për qytetarët se, komunikimi i një shefi të kabinetit të një ministri nuk ka asnjë relevancë zyrtare me Kryetarin e Komunës. Së dyti, ai theksoi se, në shkresë nuk është thënë se projekti u dëmtua nga vërshimet, por është thënë se Komuna nuk e ka paraparë buxhetin. Lidhur me këtë, shprehu pakënaqësinë e tij që një shef kabineti i mban ligjëratat atij si Kryetar i Komunës, duke shtuar se, nuk e lexoi të gjithë e-mailin, por iu referua vetëm datave. Në fund, Kryetari deklaroi se do ta tërheqë këtë pikë nga rendi i ditës, vetëm nëse vjen një sigurim zyrtar nga Ministria për zhvillimin e këtij projekti sa më shpejt të jetë e mundur.

**Xhavit Drenori** bëri të ditur se, janë bërë përpjekje të gjithanshme për të gjetur një zgjidhje për këtë urë dhe se sot ka një lajm shumë të mirë për qytetarët e Shtrubulloves. Drenori shprehu shpresën se, ky projekt nuk do të shfrytëzohet për fushatë elektorale, pasi të dyja palët, si ekzekutivi, ashtu edhe ministri e kanë trajtuar këtë çështje me seriozitet, ndonëse zotimi i ministrit duhej të dërgohej zyrtarisht me shkrim përmes një e-maili. Ai rikujtoi se ura po ndërtohet me taksat e qytetarëve, pa marrë parasysh nëse financohet nga buxheti nacional apo ai lokal. Megjithatë, ai u shpreh pro shtyrjes së vendimit të paktën për një mbledhje, duke kërkuar nga Kryetari që të sigurohet një zotim i qartë nga Ministria lidhur me afatin kohor të rregullimit të urës. Duke marrë si shembull një projekt në Nekoc që ende nuk është realizuar, ai theksoi se, me këtë urë nuk duhet bërë lojë apo fushatë, ku sot premtohet e nesër arsyetohet me mungesë buxheti. Sipas tij, gjithçka do të jetë në rregull vetëm nëse ministri dërgon një konfirmim me shkrim për anëtarët e Kuvendit, ku garanton kryerjen e punimeve në afatin më të shpejtë të mundshëm.

**Mehedin Salihu** u shpreh, më vjen keq, por unë aspak nuk i besoj zotimit të ministrit. Banorët janë duke vuajtur dhe nuk kanë kohë të presin nëse do të vendosë Qeveria apo ne. Unë jam pro që kjo pikë të mbetet në rend të ditës. Kemi rastin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), të cilën e kanë marrë si zotim për ta rregulluar, por aty është bërë një kanal që të vjen keq ta shohësh. Ka edhe raste të tjera, ndaj binduni që kjo punë vetëm sa do të shtyhet, ndërsa njerëzit do të vazhdojnë të vuajnë për të shkuar në shtëpitë e tyre. Është më mirë të sakrifkohet

buxheti ynë se sa të presim, sepse nesër përsëri do të na duhet të marrim vendim që ta rregullojmë vetë.

**Egzona Tërdevci** tha se, ne kemi pritur deri tani, prandaj mund të presim edhe disa javë derisa të kryhen procedurat. Qëllimi është që ato mjete që janë paraparë për ndërtimin e urës t'i shfrytëzojmë për projekte të cilat i kemi planifikuar më herët. Lidhur me QKMF-në, përgjegjësia është e Komunës për shkak të gabimeve në projekt, andaj kërkoj nga kolegët që të informohen saktë përpara se të deklarohen.

**Nënkryetari Arben Shala**, reagoi e nderuar, projekti fillestar është kthyer disa herë nga Ministria, zyrtarët e së cilës kanë dashur të bëjnë ndryshime në projekt, të cilat nuk kanë qenë të nevojshme, dhe ne nuk kemi pranuar t'i bëjmë ato ndryshime. Me cilin projekt ka filluar, me atë edhe do të mbarojë. Se i kujt ka qenë interesi për ndryshime, ne nuk e dimë, prandaj faji nuk është të Komuna.

**Gani Kasniqi** theksoi se, domosdoshmëria e ndërtimit të kësaj ure nuk diskutohet fare. Jam i befashuar kur dëgjoj se nuk ka pasur kod buxhetor për të kryer pagesat për projektet e Komunës së Drenasit. Sipas kësaj logjike, pa kod buxhetor paska mbetur edhe QKMF-ja e përmendur, si dhe rruga Gillobar-Komorani, ku fatkeqësisht kanë humbur jetën disa persona. Edhe projekti për rrugën Arllat-Vuçak nuk është pranuar nga Ministria, ashtu siç nuk janë pranuar asnjëherë as ndihmat për vërshimet. Në fund, e cilësoj si 'mjerim' gjendjen në të cilën na kanë sjellë këto vendime.

**Mërgim Pirraku**, u shpreh sigurisht që ka vend për debat, por besoj se u diskutua mjaftueshëm. Ne e patëm shtyrë këtë çështje për herën tjetër me qëllimin që t'i kursejmë komunës tonë 300 mijë euro dhe t'i japim mundësinë z. Basha të na dërgojë një e-mail me vendimin që merr për ndërtimin e urës, me të gjitha termat e saktë, ashtu siç e tha edhe z. Xhavit Drenori. Pra, duhet ta dimë saktë se kur do të bëhet ajo urë, dhe besoj se kështu duhet të votojmë të gjithë. Ju lus të gjithëve që të mos e shfrytëzojmë Kuvendin për deklarata politike që lidhen me fushatën. Edhe pas fushatës, le të mos hapim debate të panevojshme dhe të mos shpenzojmë kohë me gjëra që nuk na takojnë neve.

**Liman Kasniqi** tha se, sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, përderisa nuk kemi një përgjigje zyrtare nga Ministria përkatëse, unë kisha propozuar që për këtë urë të caktohet kodi buxhetor në mënyrë që ajo të hyjë në mesin e projekteve tona. Megjithatë, le të bëhet si projekt me bashkëfinancim, sepse po e shohim se çfarë fushate po zhvillohet. Kështu që unë kërkoj që kjo çështje të futet si kod buxhetor dhe si pikë e rendit të ditës. Sa i përket QKMF-së, do të kishte qenë mirë që ta linim të pika 'Të ndryshme', ku do të jepnim një sqarim në aspektin profesional. Duke qenë se këtu është i pranishëm edhe drejtori i Urbanizmit, ai do të na njoftonte më hollësisht për procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit dhe për projektin përkatës.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, deklaroi se ne, diskutuam mjaftueshëm për urën. Unë kam arsye për ta ruajtur buxhetin e komunës për investime të tjera. Sa i përket spitalit QKMF-së, ne do të ballafaqohemi në gjykatë. Për tri vite me radhë këtë çështje e ka trajtuar dhe kontrolluar USAID-i amerikan së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë. Ne kemi komunikime dhe e-maile

që e përcaktojnë projektin, të cilin e ka financuar në plotësi Ministria e Shëndetësisë. Kemi pasur një memorandum bashkëpunimi mes nesh për tri vite me radhë. Ne i kemi humbur 30% të buxhetit të Komunës, i cili ka shkuar në suficit për shkak se procedurat nuk janë zhvilluar nga Ministria. Operatori dhe Qeveria kanë nënshkruar marrëveshje dhe, si rezultat i kësaj, operatori e ka marrë avansin e buxhetit. Më pas, ai ka provuar përmes arkitektit që t'i zvogëlojë hapësirat e objektit nga 5 metra në 4 metra, me qëllim që të përfitonte sa më shumë. Mirëpo, arkitekti dhe ne nuk kemi pranuar. Pas një kohe të gjatë, Ministria ka marrë vendim ta shkëpusë kontratën, njësoj siç ndodhi në Parkun e Biznesit, për shkak të procedurave të tyre të gabuara, njësoj si në rastin e QKMF-së.

**Egzona Tërdevci** theksoi se, sa i përket projektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ai është hartuar gabim nga Komuna. Për këtë ekziston edhe mendimi i ekspertëve, si dhe zotimi i Ministrisë së Shëndetësisë, e cila ka ndarë 2.9 milionë euro. Tërdevci sqaroi se, do të vijë koha kur Ministria do t'i japë sqarimet e nevojshme dhe do t'i publikojë korrespondencat që ka pasur me Komunën, si dhe mendimet e ekspertëve. Nuk u takon asambleistëve të japin vlerësime të tilla, pasi nuk janë ekspertë të ndërtimit të QKMF-ve. Sa i përket pjesës së rrugës, Tërdevci shtoi se, nuk është mirë të konstatohet se aksidentet me fatalitet kanë ndodhur në mungesë të rrugës me katër korsi. Sipas saj, nuk është e rrugës që z. Krasniqi të deklarohet kështu, pasi nuk janë ekspertë të sigurisë. Në fund, vuri në dukje se koha do t'i dëshmojë projektet që janë duke u realizuar dhe ato që pritet të bëhen.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** deklaroi se, projekti i hartuar pa pagesë nga Hamdi Qorri të cilin e falënderoi publikisht i cili plotëson të gjitha kriteret e nevojshme. Bëri të ditur se, gjykata do të vendosë se kush ka pasur të drejtë, pasi është një procedurë që po zhvillohet. Sipas tij, situata ku një kontraktor nënshkruan kontratën dhe pastaj kërkon ta bëjë vetë projektin, përbën konflikt interesi. Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, njoftoi se, po e tërhoq nga votimi deri në mbledhjen e ardhshme, nëse nuk marrin një përgjigje nga Qeveria. Krejt në fund, tha se, beson që deri në përfundim të kësaj mbledhjeje, Egzonës do t'i vijë ndonjë e-mail zyrtar nga Ministria.

**Gani Krasniqi** sqaroi se, nuk ka thënë që Egzona nuk i realizon projektet në Drenicë, por se është Qeveria ajo që nuk i ka përfunduar projektet në këtë rajon. Krasniqi shtoi se nuk dëshiron të hyjë më thallë në detaje rreth kësaj çështjeje.

**Liman Krasniqi** tha se, sa i përket projektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), pëlqimin për çdo ndryshim në projekt e jep ekskluzivisht kompania projektuese, pa marrë parasysh kërkesat e operatorit ekonomik. Krasniqi bëri të ditur se, projekti aktual është i pranuar ligjërisht, mbi bazën e tij është lëshuar leja e ndërtimit dhe është nënshkruar kontrata, prandaj kontraktori ka pasur obligim që t'i paraqiste të metat dhe të kërkonte revidim para se të niste punët në terren, megjithëse, sipas informatave ekzistuese, ky projekt i plotëson të gjitha kriteret për objekte shëndetësore. Për të sqaruar këtë situatë, Krasniqi propozoi që Kuvendi të shfrytëzojë të drejtën e tij për të formuar një komision të përbërë nga asambleistë dhe ekspertë profesionalë, i cili do të dalë në terren për t'i verifikuar të dhënat, pasi Drejtoria e Urbanizmit e ka kontrolluar me rregull projektin para lëshimit të lejes. Ndryshimet e përfolura si zvogëlimi i lartësisë, problemet me ndriçimin dhe ngrohjen e dëmtojnë rëndë funksionalitetin e një objekti

me karakter shëndetësorë. Sa i përket projektit të urës, ai sugjeroi që ai të regjistrohet me kodin e vet buxhetor dhe, nëse Ministria siguron financimin, Komuna të hyjë në bashkëfinancim, qoftë edhe me një shumë të vogël, me qëllim që të fitojë të drejtën zyrtare për mbikçyrtjen e punimeve. Në fund, Krasniqi shprehu shqetësimin për cilësinë e punëve që kryhen nga Ministria, duke sjellë si shembull rregullimin e shtratit të lumit Drenica, ku ngushtimi i tij ka shkaktuar vërshime.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, iu drejtua** Egzonës duke e pyetur nëse mund të merrte një zotim që brenda një javë **Qeveria** të vendoste dhe t'i njoftonte zyrtarisht se ka marrë vendim për përfundimin e rrugës. Nëse kjo ndodh, saktësisht pas një javë mund të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme për të marrë vendimin e duhur, duke shmangur kështu vonesat prej një muaji.

**Egzona Tërdevci**, e falënderoi kryetarin për mirëkuptimin dhe u zotua se brenda javës zyrtarët e Ministrisë do të kontaktojnë me Drejtorinë e Infrastrukturës në Komunë. Tërdevci tha se do të vendoset komunikimi zyrtar dhe do të përcaktohet mënyra se si do të bëhet mbështetja e këtij projekti.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, konfirmoi edhe një herë se po e tërheq pikën e dytë të rendit të ditës dhe shprehu pajtueshmërinë e tij të plotë me të gjitha pikat që i ngriti asambleisti Liman Krasniqi.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** tha se, për pikën e dytë. **Pika (2):** Propozim-vendim për përfshirjen e projektit të ri kapital në tabelën 4.2 „Ndërtimi i Urës në Shtrubullojë”, e propozuar nga Kryetari Lladrovci i njëjti, si propozues, ka të drejtë ta tërheqë pikën, me zotimin e znj. Tërdevci që brenda javës do të kontaktohet nga Ministria e Infrastrukturës, për t'u konsultuar me Kryetarin dhe drejtorin.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës. **Pika (3):** Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr. 462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës Komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies përmes negocimit apo shpalljes publike.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, e ka thënë edhe në fillim që e kanë detyrim ligjor për ta shfuqizuar dhe se të njëjtin vendim prapë do ta bëjë ashtu siç ka thënë Ministria të njëjtin komision që e kanë pranuar dhe e kanë votuar ata, pra vendimin e komisionit rekomandues.

**Xhavit Drenori**, pyeti se çfarë do të ndodhë me ata njerëz që janë zgjedhur, duke shtuar se tani e kuptoi që pritet të merret një vendim tjetër nga ana e Kryetarit.

**Egzona Tërdevci**, mori fjalën. (Për shkak të problemeve teknike me audion, diskutimi nuk dëgjohet në xhirim në minutën 1:40). Por, duke u bazuar në procesverbalin e mbajtur me shkrim, ajo kërkoi që opinionet ligjore nga MAPL-ja t'u përcillen edhe asamblistëve.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, sekretaria është aty dhe e di procedurën, ndaj të gjitha e-mailet që vijnë nga Ministria, e sidomos ato që janë me vlerësime negative, t'u përcillen të gjithë asamblastëve në e-mail.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e tretë. Për votuan 22, kundër 0, abstenime 1.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës. **Pika (4):** Propozim-vendim për shfuqizimin e Rregullores për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore Nr. 02-030-01-11323 e dt. 30.03.2026.

**Drejtoresha e Administratës, Laureta Thaqi**, sqaroi arsyejen e shfuqizimit të kësaj rregulloreje. Në takimin me drejtorin e arkivave është udhëzuar se nuk kanë rregullore dhe se duhet ta bëjnë edhe listën me afatet kohore për dokumente, të cilën e kanë bërë dhe e kanë dërguar në agjenci, nga ku edhe kanë marrë pëlqimin. Më tej, ajo shtoi se kanë pritë konfirmimin nga MAPL-ja lidhur me këtë rregullore, në mënyrë që të fillojnë punën për sistematizimin e dokumenteve që gjenden në komunën e vjetër, por edhe këtu ku janë të mbingarkuar. MAPL-ja ka bërë me dije se përgjegjësc për këtë rregullore është Ministria e Ekonomisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (ose ministria përgjegjëse për administratë publike), prandaj duhet t'i referohen asaj.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, kjo do të thotë se është e njëjtë sikurse ajo për komisionin për rekomandime për pronat. Ata kanë thënë që kryetari e ka të drejtën ekskluzive për negociim dhe nuk ka nevojë që një dokument që është bërë nga ana e tyre për rekomandim të ketë ligjshmëri.

**Xhavit Drenori**, dha një këshillë që kur ka propozime të tilla, ekzekutivi të ndalet e t'i analizojë më shumë ato, duke përfshirë këtu Zyrën ligjore dhe një sërë institucionesh nën menaxhimin e kryetarit, të cilat realisht duhet t'i përgatisin ato. Tha se nuk duhet që ato të vijnë këtu në Kuvend e më pas të thuhet se nuk ka pasur nevojë, sepse ai e ka lexuar disa herë atë rregullore, andaj kërkoi që në të ardhmen të ketë më shumë kujdes.

**Drejtoresha e Administratës, Laureta Thaqi** tha se, janë konsultuar, por drejtori i arkivave ka thënë që duhet bërë dhe në atë formë kanë vepruar. Kjo punë nuk ka shkuar huq, sepse kjo rregullore do të shërbejë si rregullore e brendshme, të cilën kanë të drejtë ta bëjnë dhe kryetari e nënshkruan.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, pas përfundimit të debatit për këtë pikë, e hodhi në votim pikën e katërt. Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës. **Pika (5):** Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130,000 m<sup>2</sup>, kapaciteti 9.99 MW, vlera investive 5,800,000.00 €.

Pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, **kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** e hodhi në votim pikën e pestë. Për votuan 21, kundër 1, abstenime 2.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e gjashtë të rendit të ditës.

**Pika (6):** Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 92,000 m<sup>2</sup>, kapaciteti 5.70 MW, vlera investive 3,300,000.00 €.

**Kryesuesi** tha se, pasi nuk pati diskutime e hodhi në votim pikën e pestë. Për votuan 20, kundër 1, abstenime 1.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e shtatë të rendit të ditës.

**Pika (7):** Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-703150053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109,084 m<sup>2</sup>, kapaciteti 5.90 MW, vlera investive 5,800,000.00 €. Pasi nuk pati diskutime për pikën e shtatë, kryesuesi e hodhi në votim pikën e pestë për votuan 21, kundër 1, abstenime 2.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, prezantoi pikën e tetë të rendit të ditës.

**Pika (8):** Propozim-vendim për formimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 deri në vitin 2026. Kryesuesi tha se, para se ta hapë për diskutim, kërkon 10 minuta pauzë për shkak të formimit të komisionit, për të ditur se nga sa anëtarë formohet dhe kush do të jenë anëtarët.

Pas përfundimit të pauzës, **Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, tha se, në konsultim me grupet kuvendare, ramë dakord që ky komision të përbëhet nga pesë anëtarë:

**Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi** tha se, unë i uroj punë të mbarë këtij komisioni hetimor, ashtu siç e tha edhe Egzona. Qëllimi i këtij komisioni është të evidentojë gjetjet e duhura dhe t'i adresojë ato në Prokurorinë e Shtetit, nëse do të ketë gjetje të tilla. Pavarësisht nëse kemi apo s'kemi të drejtë me ligjin për pushtetin lokal të bëjmë komisione të këtilla, unë e dhashë aprovimin tim. Kjo do të jetë një gjë e mirë, sepse na shërben edhe për të marrë veprime në të ardhmen. Ky është një komision ad-hoc që mund të zgjasë më së shumti 6 muaj dhe më së paku 2 javë. Andaj, po kërkoj një gjë prej jush. Nuk mund të përcaktohet periudha thjesht 'nga viti 2017 deri në vitin 2026', sepse kjo nënkupton nga 1 janari i vitit 2017 deri më 31 dhjetor të vitit 2025. Nëse dëshirojmë të përfshijmë edhe vitin 2026, duhet të përcaktoni një datë të saktë, për shembull, sot, më dt. 29.05.2026. Gjëja e dytë që dua të theksoj është se jo vetëm Komunën e Drenasit, por të gjitha komunat në Kosovë dhe ministrinë e ndryshme që japin leje, i kontrollojnë Auditori i Jashtëm. Çdo gjetje në këtë drejtim, Auditori i Jashtëm e adreson të prokurori, dhe pastaj prokuroria merret me këto çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi**, kërkoi nga shefi i grupit të PDK-së, Gani Krasniqi, të propozojë anëtarin e tyre.

**Gani Krasniqi**, propozoi Ekrem Elshani.

**Driton Ajazi** tha se, pasi ka qenë kërkesë e Arigonit që të formohet ky komision, anëtar le të mbetet Arigon Sinani.

**Egzona Tërdevci**, propozoi Xhavit Drenorin dhe Liman Krasniqin.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, tregoi se, për këtë komision u propozuan këta emra: Burim Bujupi, Ekrem Elshani, Arigon Sinani, Xhavit Drenori dhe Liman Krasniqi. Me këtë përbërje e hodhi në votim pikën e tetë të rendit të ditës. Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e nëntë të rendit të ditës.

**Piken (9):** Mbështetje financiare e njëhershme për fëmijët me Sindromën Down.

**Egzona Tërdevci**, besoj që të gjithë që jemi prezentë këtu ju kujtohet që ky nuk është propozim imi për fushatë, por është që nga muaji mars. Mundeni edhe mos ta votoni tani, por mua më duhet ta di a keni mjete buxhetore dhe a mundemi ta bëjmë brenda këtij viti. Për mua është e rëndësishme që si Komunë e Drenasit të mund ta mbështesim një kategori që ka nevojë për mbështetjen tonë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, si propozuese që qenkeni prej muajit mars, po pres me ditë sa është shuma totale e mjeteve financiare që mund t'ia propozojmë Kuvendit me votu.

**Egzona Tërdevci** tha se, do të kërkoj prej Drejtorisë së Shëndetësisë me ma siguru numrin e fëmijëve që i ka Komuna e Drenasit me Sindromën Down dhe e kalkuloj, nuk është problem.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, ku thoni që e ke propozuar prej marsit e nuk e ke numrin dhe nuk e din shumën, çka po kërkon. D.m.th. je duke bërë fushatë me fëmijët të cilët kanë shumë nevojë për ndihmën tonë. Unë nuk kam mjete në këtë rast për subvencionim, por duhet të shohim dhe të pyesim edhe Ministrinë se si të veprojmë, në qoftë se na duhet me patjetër.

**Xhavit Drenori** theksoi se, duke pasur parasysh që kjo çështje është bërë publike dhe se ekziston gatishmëri nga ana e kryetarit për ta shqyrtuar atë, propozon që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Sipas tij, deri atëherë duhet të sigurohen informacionet e nevojshme lidhur me numrin e fëmijëve përfitues dhe linjën buxhetore nga e cila do të financohet kjo mbështetje. Drejtoria përkatëse mund t'i identifikojë fondet e nevojshme. Tha se pajtohet që pa të dhëna dhe informacione të sakta nuk mund të merret një vendim i tillë, si dhe kjo çështje nuk është dashur të trajtohet në këtë mbledhje, duke pasur parasysh se jemi në periudhë fushate zgjedhore.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, kur flet për këtë kategori të fëmijëve, duhet me ditë a është fjala për ata në institucione arsimore, sepse në institucione arsimore të paraqitur ne i kemi 80 fëmijë, por kemi fëmijë që nuk janë as në çerdhe e as në shkollë, pra ne nuk guxojmë me bërë diskriminim për njërin po e tjetrin jo. Egzon, a po vazhdon me pikën a don me e tërheq.

**Egzona Tërdevci** tha se, unë e kam propozuar duke e kërkuar mirëkuptimin tuaj, a ka mundësi me u bërë, prandaj t'u kisha lutur edhe ty me e tërheq fjalën që e the për fushat edhe jemi dakord.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** unë nuk e tërheq, sepse nuk kam thënë asgjë që nuk është, unë besoj ashtu dhe t'i nuk mundesh me më bind me e tërheq fjalën, ne po themi që nuk kemi mjete, duhet me më tregu më hcrët me mund me i pa mundësitë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, iu drejtua znj. Lërdevci pika jote në Komitetin për Politikë e Financa është pyetje dhe përgjigje për drejtorët dhe është e rekomanduar, në qoftë se e gjen në procesverbal që ke bërë kërkesë për këtë pikë, unë kam me dhënë dorëheqje, po në qoftë se nuk e gjen, a jep dorëheqje t'i prej asamblesë. Po nuk e ke kërkuar dhe mos u muado me manipulu opinionin, në dy komitete më herët nuk ke qenë fare, puro për fushat jo duke e bërë, nuk ke bërë kërkesë. Pyetja ime për ty është: A po e tërheq apo nuk po e tërheq pikën e nëntë. "Mbështetje financiare e njëhershme për fëmijët me Sindromën Down". E propozuar nga Egzona, Egzona e tërheq dhe po e lë në dorë të kryetarit dhe drejtorit për me i shikuar mundësitë se çfarë mundesh me bërë në të ardhmen. Pra, kjo pikë nuk ka nevojë të hidhet në votim, vazhdojmë me **Pikën (10): "Të ndryshme"**.

**Egzona Tërdevci** tha se, e kam një pyetje, po e adresoj një shqetësim të zjarrfikësve të Komunës së Drenasit që nuk iu paguhen orët e vikendeve, kurse komunat e tjera ua paguajnë, vetëm desha të marr informacione për këtë çështje.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sa i përket pyetjes për zjarrfikësit, kur janë ndarë zjarrfikësit prej nivelit qendror dhe janë bërë barrë e jona, e kanë pasur gjysmë koefficienti më të vogël se zjarrfikësit e tjerë dhe kemi pasur numrin më të vogël të zjarrfikësve se sa komunat e tjera, domethënë është bërë diskriminim dhe unë atë gjysmë koefficienti, e dini çfarë, ua kam rritur. Ata punojnë me ndërrime dhe kur punojnë me ndërrime nuk llogaritet vikendi, sepse ata e kanë pushimin e përcaktuar me ligj. Zjarrfikësit e bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe u jemi mirënjohës për punën që bëjnë dhe i mbështesim në çdo aspekt, por atë që nuk e kemi me ligj, më vjen keq, por nuk mundemi me e bërë, jo vetëm për zjarrfikësit por për askënd.

**Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda**, ashtu siç e tha edhe kryetari, zjarrfikësit e bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe u jemi mirënjohës për punën, jemi vazhdimisht në bashkëpunim me ta. Ndërrimet e natës edhe orët jashtë orarit të punës, si dhe të festave, po paguhen vazhdimisht, kemi pasur disa ngecje për çështje të buxhetit, por iu kanë kthyer retroaktivisht. Sa i përket pagesës së vikendeve, disa komuna po i paguajnë, por ndoshta kanë buxhet tjetër. Zjarrfikësit e kanë orarin rrëshqitës, atyre mund të ndodhë që iu bie të shtunën e të dielën me punuar, mirëpo të hënën e të martën me pas pushim, Komuna nuk ka buxhet për të bërë pagesën e vikendeve.

**Naim Xheli**, kishte një pyetje për drejtorin e gjcodezisë. E kemi një problem me një familje Hoti, kanë problem me skicat e pronave të tyre, shtëpia iu figuron diku në shkollë, e shkolla në shtëpinë e tyre. I kanë bërë disa kërkesa, por nuk e di ku kanë ngecur. Ata kanë nevojë t'ua rregulloni këtë problem, sepse nuk po mund ta ndajnë pronën e tyre. A mundeni t'ua jepni ndonjë shpjegim që të kuptojnë familjarët se ku është problemi.

**Drejtori i Gjeodezisë, Arian Krasniqi**, i nderuar, ne kemi biseduar edhe me Safetin dhe po besoj disa informacione edhe i keni marrë. Ne jemi duke e trajtuar problemin dhe sa ta kemi informacionin e plotë, do t'ju njoftojmë ty dhe palën që ka kërkuar.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovc**i tha se, ata e meritojnë një trajtim sa më të shpejtë, është gabim i parcelave, sepse ata vetë e kanë falur edhe atë pronë që është në emër të shkollës dhe besoj që zgjidhet. Por, te pronat, për të gjithë juve, asnjë ndërhyrje nuk kemi të drejtë të bëjmë, sepse është i vetmi send që unë nuk kam të drejtë t'i jap urdhër kadastrës së pronës dhe gjeodezisë. Unë kam të drejtë të marr vendim edhe të jap urdhër kur janë pronat publike, por jo të tjerat.

**Xhavit Drenoric** ngriti një çështje dhe tha se, në javën që shkoi patëm një lajm të mirë në komunën tonë, u përrua shtëpia muze e shkrimtarit të mirënjohur të komunës sonë, Ymer Elshani. Ky është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, historike dhe shpirtërore, dhe një dëshmi se Komuna jonë ka çfarë t'i tregojë jo vetëm qytetarëve tanë, por edhe vizitorëve të shumtë që vijnë çdo ditë.

Mirëpo, krahas këtij zhvillimi pozitiv, mendoj se kemi edhe një nevojë konkrete që duhet ta trajtojmë me seriozitet institucional.

Në Komunën tonë kemi pika të rëndësishme historike e kulturore që vizitohen vazhdimisht nga delegacione vendore e ndërkombëtare, nga nxënës, studiues, mërgimtarë e vizitorë të ndryshëm. Po flas për shtëpinë muze në Poklek, për shtëpinë muze të Ymer Elshanit në Korroticë, për vendin ku ranë Fehmi Lladrovc dhe Xhevë Lladrovc me dëshmorët e tjerë, si dhe për kalanë e Vuçakut e shumë pika të tjera me rëndësi për historinë tonë.

Sot në shumicën e rasteve, barra për t'i pritur dhe udhëzuar vizitorët mbetet mbi familjarët e dëshmorëve dhe martirëve apo mbi njerëz të afërt të këtyre ngjarjeve.

Ata, me shumë vullnet e respekt i presin vizitorët dhe tregojnë rrëfimet e dhimbshme të historisë tonë.

Por duhet ta pranojmë se nuk është e lehtë që familjarët ta rikthejnë vazhdimisht atë dhimbje sa herë që vijnë vizitorë. Prandaj, propozoj që ekzekutivi komunal, konkretisht Drejtoria për Kulturë, të shqyrtojë mundësitë buxhetore për angazhimin e një cicroni profesional, i cili ose e cila flet edhe gjuhën angleze, dhe që mund të angazhohet qoftë me kontratë apo me honorar të përkohshëm.

Ky person do të ishte në dispozicion sipas nevojës, kur kemi delegacione, grupe vizitorësh apo kërkesa të veçanta për vizita në këto pika historike e kulturore. Një qasje e tillë do të sillte disa përfitime të rëndësishme:

Do të kemi prezantim më profesional të historisë dhe kulturës sonë;

Do t'u lehtësohet barra emocionale familjarëve;

Do të krijohet një standard institucional për pritjen e vizitorëve;

Dhe mbi të gjitha, historia jonë do të prezantohet me dinjitet para vendorëve dhe ndërkombëtarëve.

Ne kemi shumë për të treguar si komunë, kemi histori të lavdishme, kulturë, sakrificë dhe personalitete të rëndësishme. Prandaj, është përgjegjësi e institucioneve tona që këto vlera të prezantohen në mënyrë profesionale dhe të organizuar. Besoj se ky është një propozim i arsyeshëm dhe i realizueshëm, dhe shpresoj që ekzekutivi dhe Drejtoria për Kulturë ta marrin në konsideratë me seriozitet.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovi** tha se, ideja është perfekte, por kjo kategori i takon Agjencisë për Menaxhimin e Memorialeve dhe ne i bashkohemi kërkesës t'nde që agjencia t'i marrë të gjitha ato varreza dhe institucione të tjera publike kulturore nën menaxhim, sepse është duke u bërë njëfarë selektimi, ose nuk i ka futur ende nën ombrellë për me mundur me i mbikëqyrë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** konstatoi se, pasi nuk pati diskutime të tjera, e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:30.*

**Procesmbajtësja: Fakete Hoti**

**Lekturoi: Nikelinda Bujupi**



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Burim Bujupi**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit



DATE:	15/06/2026
PËR:	Z. Burim Bujupi-Kryesues i Kuvendit të Komunës Komitetin për Politikë dhe Financa Kuvendin Komunal
Kopje:	Sekretarisë së Kuvendit
NGA:	Ramiz Lladrovci, Kryetar I Komunës së Drenasit
Lënda:	Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029



Të nderuar/a,

Ju përcjellim draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029, i cili paraqet bazën për hartimin e buxhetit komunal për vitin 2027 dhe projeksioneve buxhetore për vitet 2028-2029.

Dokumenti është hartuar në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, pas zhvillimit të diskutimeve publike dhe konsultimeve me drejtoritë komunale.

Ju lutem, gjeni të bashkëngjitur draft-dokumentin për shqyrtim dhe diskutim.

Me respekt!



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
**Komuna/Opstina/Municipality Drenas**  
**Zyra e Kryetarit**



**KORNIZA**  
**AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE**  
**2027 - 2029**

**Drenas, qershor 2026**

## PËRMBAJTJA

### I. HYRJE

### II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME

### III. KORNIZA FISKALE

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2027-2029
- 3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Financimi i Jashtëm
- 3.4 Politikat e reja
- 3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2027-2029
- 3.6. Analiza Gjinore

### IV. KORNIZA E PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE

### V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

#### I. HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB-i), që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB-i, siguron mekanizmat e nevojshëm për të arritur objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integrimit sa më të mirë në procesin buxhetor.

**Kuadri Ligjor:** Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komonale 2027/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT-ja) në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP-it).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027-2029. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## II. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME 2027-2029 NGA STRATEGJIA ZHILLIMORE KOMUNALE

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, në një sipërfaqe prej: 275.63 km<sup>2</sup>, apo 2.66 për qind e sipërfaqës së territorit të Kosovës. Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Drenasit ka gjithsej 42 vendbanime. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë, Komuna ka 48,079 banorë.

Zhvillimi i qëndrueshem ekonomik, fokusimi në krijimin e një mjedisi sa më të favorshëm biznesor, modernizimin e infrastrukturës, përkrahjen e vazhdueshme të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Transporti dhe komunikimi, Mjedisi dhe planifikimi hapësinor.

Administrata e Komunës së Drenasit është e organizuar përrreth zyrave qendrore dhe zyrës lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat 1 (një) zyre është e vendosur në fshat.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike siç janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-i) 2027-2029 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve në bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore 2027 (I)+(II), të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qarkoreve të brendshme buxhetore (I) + (II).

**Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Drenasit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.**

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti - llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve binjake prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër (4) prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Drenasit:

### **1. FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE ME MUNDËSI PËR TË GJITHË**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimin të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për studime, laboratore dhe kabinete)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor

### **2. PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SË QYTETARËVE**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Përkrahja për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

### **3. PËRMIRËSIMI I AMBIENTIT TË KOMUNËS DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ**

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimin dhe rigjenerimin të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimin të standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

#### **4. KRIJIMI I QEVERISË KOMUNALE QË OFRON SHËRBIME EFIKASE DHE QË U PËRSGJIGJET KËRKESAVE TË QYTETARËVE**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë.

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2027-2029 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë kryesore ekonomike të shpenzimeve të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve. Alokimi i shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave, si dhe arritje e vlerës më të madhe për fondet e shpenzuara.

### **III. KORNIZA FISKALE KOMUNALE**

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e Qeverisë Qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë (Tabela 1:Indikatorët Ekonomik). Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të siguroj respektimin e rregullës fiskale për deficitin, i cili nuk mund të jetë më i lartë se 2% e Bruto Produktit Vendor, sipas Lirgjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë (LMFPP) si dhe rregullin fiskal të pagave sipas Ligjit 05/L-048. Komuna nga ana e saj do të tregoj lidhur me atë se si plani buxhetor do të reflektoj në buxhetimin e obligimeve ndërsa hapsira e lirë fiskale të jetë e planifikuar sipas prioriteve dhe dokumenteve strategjike.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve) si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Drenasit në periudhën afatmesme buxhetore 2027-2029 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

#### **3.2. TË HYRAT KOMUNALE DHE PARASHIKIMI AFAT-MESËM 2027-2029**

Të hyrat e Komunës së Drenasit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

**Tabela 2: Buxheti total i komunës në vite , shprehur në € (Euro) :**

Të hyrat sipas sektorve	Aktuali	Projeksioni	Projeksioni provues	
	2026	2027	2028	2029
Spektori i Administratës	10,162,859.00	12,712,172.00	13,538,481.00	14,534,384.00
Spektori i Arsimit	10,659,134.00	9,140,582.00	9,415,000.00	9,697,590.00
Spektori i Shëndetësisë	2,912,540.00	2,538,088.00	2,552,271.00	2,694,709.00
<b>Gjithsej të hyrat:</b>	<b>23,734,533</b>	<b>24,390,842.00</b>	<b>25,505,752.00</b>	<b>26,926,683.00</b>

Në bazë të planifikimit të bërë në vitin 2027, të hyrat buxhetore për Komunën si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e të hyrave buxhetore për vitin 2027 do të jetë mesatarisht 2.76% në krahasim me vitin 2026 (sipas vendimit të buxhetit). Sipas të dhënave të prezantuara në tabelë, rritja e të hyrave në vitin 2027, kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme që planifikohet në nivel të Qeverisë, siç parashihet me KASH-in 2027-2029 rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm dhe Grantin Specifik të Arsimit.

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, do të kenë një rritje të lehtë nga viti në vit, po ashtu (vlerësim ky nga niveli qendror). Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat jotatimore.

#### **KALKULIMET E TATIMIT NË PRONË:**

- *Vlera e patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori të zonave
- *Vlera e kalkuluar vjetore*- që duhet të mblidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e pagesës vjetore*- Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i akumuluar dhe pagesa e pritur e borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

#### **KALKULIMET E TË HYRAVE TJERA:**

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të komunës janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe ngarkesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara nga programet buxhetore.

**Tabela 3: Planifikimi i të hyrave buxhetore komunale sipas burimit të financimit dhe kategorive të të hyrave për periudhën 2027-2029, shprehur në € (Euro)**

	Komuna: Drenas (Glllogoc)	Grantet dhe THV – 2027	Grantet dhe THV – 2028	Grantet dhe THV - 2029
	<b>BURIMET E TË HYRAVE</b>	(vitin e 1)	(vitin e 2)	(vitin e 3)
<b>Kodi 10</b>	<b>GJITHSEJ GRANTET (Fondi10)</b>	<b>22,056,965</b>	<b>23,098,423</b>	<b>24,401,447</b>
	Granti i Përgjithshëm	10,470,295.00	11,227,152.00	12,109,148.00
	Granti Specifik i Arsimit	9,080,582.00	9,353,000.00	9,633,590.00
	Granti Specifik i Shëndetësisë	2,506,088.00	2,518,271.00	2,658,709.00
	Tatimi në pronë	816,250.00	824,412.00	828,535.00
	Tatimi në tokë	229,650.00	230,798.00	231,952.00
	Licencat dhe lejet	170,000.00	175,000.00	180,000.00
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	51,000.00	52,000.00	53,000.00
	Taksat e pajisjeve motorike	132,000.00	135,000.00	137,000.00
	Lejet per ndertesa	100,000.00	110,000.00	110,000.00
	Taksat tjera komunale	130,000.00	132,000.00	135,000.00
	Te hyrat nga qiraja	80,000.00	85,000.00	87,000.00
	Ngarkesat tjera komunale	55,000.00	55,000.00	55,000.00
	Të hyrat nga gjykatat	50,000.00	55,000.00	60,000.00
	Të hyrat nga gjobat në trafik	427,977.00	457,119.00	547,749.00
<b>I</b>	<b>Totali i Administratës Komunale</b>	<b>2,241,877.00</b>	<b>2,311,329.00</b>	<b>2,425,236.00</b>
	Qerdhet- (bashk-pagesat)	60,000.00	62,000.00	64,000.00
<b>II</b>	<b>Totali – Arsimi</b>	<b>60,000.00</b>	<b>62,000.00</b>	<b>64,000.00</b>
	Shëndetësia –(participimi)	32,000.00	34,000.00	36,000.00
<b>III.</b>	<b>Totali - Shëndetësia</b>	<b>32,000.00</b>	<b>34,000.00</b>	<b>36,000.00</b>
<b>Kodi 21</b>	<b>TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNË S (I+II+III) Fondi 21:</b>	<b>2,333,877.00</b>	<b>2,407,329.00</b>	<b>2,525,236.00</b>
	<b>TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE (10+21)</b>	<b>24,390,842.00</b>	<b>25,505,752.00</b>	<b>26,926,683.00</b>

Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2027-2029) do të përbëjnë afërsisht **89.55%** të buxhetit total të komunës. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **10.44%**. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Qarkoren Buxhetore 2027-01 lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Maj/2026.

### **3.2.2. Politikat e reja**

Komuna e Drenasit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar Qeveria e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, për Komunën e Drenasit do të vazhdojë të jetë një risk numri i popullsisë që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj diference-negative që do të shkaktoje ulje e nivelit të Grantit të Përgjithshëm për komunën.

Në vitin e ardhshëm komuna kërkohet t'i trajtojë obligimet kontraktuale dhe me pjesën e mbetur të buxhetit të planifikoj zhvillimin e projekteve të reja

Sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunë, përkatësisht në Sektorin e Arsimit është edhe politika për staf të ri ndihmës për qerdhe dhe transport të nxënësve si dhe në Sektorin e Shëndetësisë politika për intervenim në fëmijërinë e hershme.

### **3.3.SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE AFAT-MESËM 2027-2029**

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore MFT. 2027/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2027, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Shtesa. Si rezultat Komuna e Drenasit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike të shpenzimeve buxhetore:

Tabelat e kërkesave fillestare buxhetore (2027-2029) sipas programeve-nën programeve buxhetore dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve, shprehur në € (Euro) :

**Tabela 5: Kërkesat fillestare buxhetore sipas Qarkores Buxhetore 2027-01 (për vitin 2027)**

Programet:	Staf 2027	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e	Investimet kapitale	Gjithsej:
Zyra Kryetarit	22	265,757	108,286		40,000		414,043
Administrata	41	333,306	180,849			150,000	664,155
Inspekcioni	10	98,598	31,360				129,958
Zyra e Kuvendit	27	327,189	20,250				347,439
Buxhet dhe Financa	18	159,121	27,000				186,121
Shërbime Publike	25	275,522	490,750	281,150	110,000	90,000	1,247,422
Infrastrukturë Publike	9	93,533	22,000			3,998,500	4,114,033
Zyra për Komunitete dhe Kthim	1	12,597	890				13,487
Bujqësia dhe zhvillimi rural	7	77,810	16,900		90,000		184,710
Cjcodezia, kadastra dhe prona	13	132,789	8,000				140,789
Planifikimi Urban	9	92,170	70,650			165,000	327,820
Zhvillimi ekonomik	8	81,667	31,550		80,000		193,217
Kultura, Rinia dhe sporti	15	103,064	85,256		150,000	602,000	940,320
Administrata e Shëndetësisë	5	51,440	8,540		100,000		159,980
QKMF	209	2,497,968	800,968	57,600		120,000	3,476,536
Qendra për punë sociale	14	135,589	26,800	12,000	8,000	230,000	412,389
Administrata Arsimit	10	104,880	280,375		100,000		485,255
Arsimi parafilor	42	305,985	90,000	10,000			405,985
Arsimi fillor	735	7,000,323	568,700	60,000	158,065	847,000	8,634,088
Arsimi i mesëm	174	1,764,742	107,353	16,000		25,000	1,913,095
<b>Gjithsej shpenzi.</b>	<b>1394</b>	<b>13,914,050</b>	<b>2,976,477</b>	<b>436,750</b>	<b>836,065</b>	<b>6,227,500</b>	<b>24,390,842</b>


**Tabela 6: Kërkesat fillestare buxhetore sipas Qarkores Buxhetore 2027-01 (për vitin 2028)**

Programet:	Staf 2028	Paga dhe Shtesa	Mall dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e	Investime Kapitale	Gjithsej:
Zyra Kryetarit	22	267,256	111,420		41,500		420,176
Administrata	41	333,506	185,740				519,246
Inspckcioni	10	99,445	29,320				128,765
Zyra e Kuvendit	27	329,939	20,550				350,489
Buxhet dhe Financa	18	160,157	27,000				187,157
Shërbime Publike	25	289,513	467,875	295,207	110,000	245,000	1,407,595
Infrastrukturë Publike	9	94,218	22,000			5,255,824	5,372,042
Zyra për Komunitete dhe Kthim	1	12,680	920				13,600
Bujqësia dhe zhvillimi rural	7	78,371	17,220		100,000		195,591
Gjeodezia, kadastra dhe prona	13	133,732	13,700				147,432
Planifikimi Urban	9	92,804	78,050			100,000	270,854
Zhvillimi ekonomik	8	82,239	41,020		100,000		223,259
Kultura, Rinia dhe sporti	15	103,826	95,950		180,000	635,000	1,014,776
Administrata e Shëndetësisë	5	51,840	8,000		100,000		159,840
QKMI <sup>2</sup>	209	2,522,166	803,000	55,300		120,000	3,500,466
Qendra për punë sociale	14	136,467	26,400	13,000	6,000	200,000	381,867
Administrata Arsim	10	105,925	280,660		100,000		486,585
Arsimi parafillor	42	307,886	92,000	10,000			409,886
Arsimi fillor	735	7,033,131	586,570	60,000	165,000	570,000	8,414,701
Arsimi i mesëm	174	1,775,175	110,250	16,000			1,901,425
<b>Gjithsej shpenz.</b>	<b>1394</b>	<b>14,010,276</b>	<b>3,017,645</b>	<b>449,507</b>	<b>902,500</b>	<b>7,125,824</b>	<b>25,505,752</b>

**Tabela 7: Kërkesat fillestare buxhetore sipas Qarkores Buxhetore 2027-01 (për vitin 2029)**

Programet:	staf 2029	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencion e	I.Kapitale	Gjithsej:
Zyra Kryetarit	22	279,086	86,831		43,200		409,117.00
Administrata	41	333,806	211,840				545,646.00
Inspekcioni	10	110,217	29,980				140,197.00
Zyra e Kuvendit	27	331,989	20,850				352,839.00
Buxhet dhe Financa	18	161,192	27,000				188,192.00
Shërbime Publike	25	302,012	482,751	309,967	115,000	60,000	1,269,730.00
Infrastrukturë Publike	9	94,923	22,000			6,811,500	6,928,423.00
Zyra për Komunitete dhe Kthim	1	12,767	970				13,737.00
Bujqësia dhe zhvillimi rural	7	78,950	17,320		110,000		206,270.00
Gjeodezia, kadastra dhe prona	13	103,448	14,200				117,648.00
Planifikimi Urban	9	93,561	81,450			200,000	375,011.00
Zhvillimi ekonomik	8	82,828	44,020		130,000		256,848.00
Kultura, Rinia dhe sporti	15	104,617	97,450		185,000	413,000	800,067.00
Administrata e Shëndetësisë	5	52,301	8,000		100,000		160,301.00
QKMF	209	2,546,353	803,000	55,300		120,000	3,524,653.00
Qendra për punë sociale	14	137,385	27,300	13,000	6,000	200,000	383,685.00
Administrata Arsim	10	107,103	280,660		100,000		487,763.00
Arsimi paralëlor	42	309,266	94,000	10,000			413,266.00
Arsimi fillor	735	7,067,455	597,270	60,000	170,000	560,000	8,454,725.00
Arsimi i mesëm	174	1,786,312	112,253				1,898,565.00
<b>Gjithsej.shpenz</b>	<b>1394</b>	<b>14,095,571</b>	<b>3,059,145</b>	<b>448,267</b>	<b>959,200</b>	<b>8,364,500</b>	<b>26,926,683.00</b>

Tabelat e lartshënuara, paraqesin planifikimin e shpenzimeve sipas karakterit ekonomik dhe funksional për vitet 2027-2029, bazuar në kërkesat fillestare të mbajtësve të buxheteve komunale (drejtoratet dhe zyrat komunale). Vlerësimet e përgjithshme për kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve për vitin 2027 janë si më poshtë:



**3.3.1 Pagat dhe Shtesat** - Për kalkulimin e pagave për vitin 2027 duhet të merrret për bazë për përllogaritje të pagave muaji prill 2026 duke përfshirë rritjen e planifikuar të koeficientit për 0.5 për çdo vit të plotë pune. Ndërsa për punëtorët e papunësuar duhet përllogaritur paga mesatare dhe duhet buxhetuar vetëm 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

**3.3.2 Mallra dhe Shërbime**- Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë

**3.3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Komunale:** priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2026.

**3.3.4 Subvencionet dhe transferet:** pritet të kenë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë në buxhet me vitin 2026.

**3.3.5 Investimet kapitale** përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet të përfaqësojnë rreth 27% të shpenzimeve totale.

**Përparësi për financim duhet të kenë projektet në vazhdim që janë inicuar në vitet paraprake dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Komunës.**

Shërbimet sociale rezidenciale duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm në vlerë prej 230,000.00€ për vitin 2027, 200,000.00€ për vitin 2028 dhe 200,000.00 € për vitin 2029.

Duhet pas parasysh se projektet e reja duhet të caktohen në përputhje me Udhëzimin administrative për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale.

### 3.4 Analiza Gjimore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor.

Meqenëse deri më tani është punuar në projekte kapitale të infrastrukturës, ndarja buxhetore nuk ka mund të bëhet sipas barazisë gjinore. Komuna në të ardhmen do të mundohet që të bëjë planifikimin e investimeve kapitale në proporcion të barazisë gjinore. Me zvogëlimin e numrit të projekteve në infrastrukturë, do të mbesin mjete për projekte tjera dhe do të merret parasysh më për së afërmi barazimi gjinor gjatë shqyrtimit të projekteve të ndryshme. Komuna tani për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor ka një analizë, e cila do të shërbejë si bazë për ndarjen buxhetore sipas barazisë gjinore. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave.

## V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

### ZYRA E KRYETARIT

**Misioni:** Bën mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson komunën, në pajtim me Kryesuesin e Kuvendit konvokon mbledhjet e Kuvendit të komunës, nënshkruan të gjitha aktet e aprovuara nga Kuvendi Komunal, kujdeset për zbatimin e ligjit , rregulloreve dhe Statutit të komunës, bënë propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të komunës. Kjo zyrë ka gjithsej 19 punëtorë.

**Vizioni:** Avancimi dhe perfeksionimi i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore. Arritja e pajtueshmërisë së plotë me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon komuna. Shfrytëzimi i mjeteve buxhetore me një nikoqirllëk dhe duke u bazuar në parimin vlera për paratë. Avancimi i vazhdueshëm profesional i të gjitha burimeve humane.

**Qëllimi:** Ngritja e zhvillimit ekonomik. Ngritja e nivelit të mirëqenies sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim . Ofrimi sa më i mirë i të gjitha shërbimeve për qytetarët e komunës. Shndërrimi i administratës në një administratë moderne, sa më funksionale dhe të rregullt. Shfrytëzimi sa më racional dhe ekonomik i të gjitha burimeve njerëzore, financiare dhe materiale që ka komuna në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Nr.	Numri i të punësuarve dhe shërbimeve	2027	2028	2029
1	Numri i të punësuarve	22	22	22
2	Numri i shërbimeve			
	Konvokimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me kryesuesin	12	12	12
	Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për politikë dhe financa dhe komitetet tjera	12	12	12
	Përfaqësimi i Komunës brenda dhe Jashtë vendi	15	15	15
	Organizimi i mbledhjeve me publikun dhe përfaqësuesit e komuniteteve			
	Kryerja e auditimeve të rregullta	7	7	7

Raportimet para Komitetit të Auditimit	4	4	4
Kryerja e auditimeve të rregullta	7	7	7
Raportimet para Njesisë Qendrore Harmonizuese	2	2	2
Bashkëpunimi me ZAP-in	1	1	1
Bashkëpunimi më mediat e shkruara dhe elektronike	365	365	365
Redaktimi i faqes zyrtare të informimit të Komunës	350	350	350
Rekrutimet e punonjësve të rinjtë	25	25	25
Trajnimi i punonjësve	80	80	80
Raportimi për rrjedhën e detyrave në lidhje më PVPE	2	2	2
Bashkëpunimi e mbikq. në realiz. e det që dalin nga PVPE	24	24	24
Përfaqësimi i Komunës në Kontestet gjyqësore	176	160	140
<b>Gjithsej: kuantitativ</b>	<b>1,104</b>	<b>1,088</b>	<b>1,068</b>

Për realizimin e punëve të planifikuara me lartë më afat, kualitet duhet të sigurohën mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

## ZYRA E KUVENDIT

**Misioni:** Zbatueshmëria e ligjeve në fuqi, përgatitja e akteve normative në përputhshmëri me ligjin si dhe arkivimin e të gjitha këtyre akteve.

**Vizioni:** Planifikimi i punëve sipas ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore dhe realizimi i këtyre punëve sipas planifikimit.

**Qëllimi:** Përgatitja e materialit për kuvend, mbajtja e procesverbaleve dhe nxjerrja e vendimeve të aprovuara nga kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve për MAPL-ë.

Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2027	2028	2029
Numri i të punësuarve	-	-	-
Numri i shërbimeve			
Punët kuantitative në nr. Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit	12	12	12
Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të KPF	14	14	14
Pranimi i propozim vendimeve nga ekzekutivi dhe dërgimi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend	60	60	60
Mbajtja e procesverbaleve në mbledhjet e KPF-së dhe Kuvendit	26	26	26
Përgatitja e vendimeve të dala nga Kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve Kryetarit të Komunë dhe MAPL	60	60	60
Takimet e Komitetit për Komunitete dhe atyre konsultative me Komisionet e Kuvendit Komunal	44	44	44
<b>Gjithsej</b>	<b>216</b>	<b>216</b>	<b>216</b>

## DREJTORATI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ushtron dhe zbaton shërbime të përgjithshme për organet administrative dhe tjera komunale, si dhe ofron shërbime për qytetarët e Komunës së Drenasit në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj.

**Misioni:** Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët në afat të shkurtër kohor dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punët e Kuvendit të Komunës, të Bordit të Drejtorëve dhe trupave tjerë punues. Të siguroj shërbime efektive për qytetarët dhe të siguroj transparencën e shërbimit civil komunal.

**Vizioni:** Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe cilësore për qytetarët, organet administrative dhe organet tjera komunale. Vizioni dhe qëllimi ynë si drejtorat është të ofrojmë shërbime më të mira komunale, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe përmes tyre të rrisim shkallën e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimet administrative komunale.

**Qëllimi:** Qëllimet e Drejtorisë së Administratës janë ngritja e performancës komunale, shërbime komunale cilësore për qytetarët dhe organet e saj administrative.

Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2027	2028	2029
Numri i të punësuarve	41	41	41
Numri i shërbimeve			
Ekstrakte certifikatash të Gjendjes Civile	46000	47000	47000
Procedura të Prokurimit Publik	125	130	135
Vërtetime të ndryshme dhe legalizim dokumentesh	300	350	375
<b>Gjithsej</b>	<b>46 425</b>	<b>47 480</b>	<b>47 510</b>

Sqarim;

140000 certifikata janë që lëshohen për jashtë vendit për tri vite, ndërsa 60000 certifikata që lëshohen brenda vendit në letër të bardhë për tri vite.

## DREJTORATI PËR INSPEKSION

**Misioni:** Drejtoria e Inspeksionit ka për mision të sigurojë zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore përmes mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit profesional, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, garantimin e rendit dhe sigurisë, si dhe ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të paanshme për qytetarët.

**Vizioni:** Të jemi një drejtori profesionale dhe e besueshme, e cila përmes kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe teknike garanton zbatim të barabartë të ligjit, rritje të sigurisë publike dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetesës në komunë.

**Qëllimi:** Të sigurohet një numër i mjaftueshëm i inspektorëve dhe stafit mbështetës, në përputhje me kompetencat ligjore, territorin e mbulimit dhe nevojat e qytetarëve, me qëllim rritjen e efikasitetit në

kryerjen e inspektimeve, reagimin në kohë ndaj kërkesave dhe ankesave, si dhe forcimin e zbatimit të ligjit në të gjitha fushat e inspektimit.

Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2027	2028	2029
Numri i të punësuarve	10	11	11
Shërbimet e Drejtorisë			
Hartimi i raporteve javore/6 mujore/vjetore	50	50	50
Shqyrtimi i Ankesave	20	30	30
Shqyrtimi i Kërkesave	40	50	50
Gjithsej:	110	130	130
Numri i shërbimeve kuantitative:			
Kontrollime	600	700	750
Procesverbale	500	600	650
Gjithsej:	1100	1300	1400
Numri i shërbimeve kualitative:			
Aktivendime	80	90	95
Fletëparaqitje (gjyba)	70	80	85
Gjithsej:	150	170	180

## DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

**Misioni:** Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efektive dhe përgjegjësi dhe konform me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të obligimit dhe detyrave që i ka për të kryer.

**Vizioni:** Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efektive dhe përgjegjësi dhe konform me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të implementimit dhe realizimin e politikave fiskale të hartuar nga Qeveria qendrore dhe implementimin e politikave lokale.

